



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ROZETA A. KUKA
ADRESA NR.9, HAXHI DALLIU
TEL: 682080653

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2138

Nr. koleksioni: 812/4.

Tirane më 19/10/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022052810085747683



A2022052810085747683



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERISË/TIRANË
NOTERE ROZETA A. KUKA



ADRESA: Rr. "Haxhi Dalliu". Përballë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë; Taksa e pullës u pagua

KONTRATË SHITJE KUOTASH (SHTOJCA Nr. 2)

Sot në Tiranë, më datën 19.10.2022 (*dymijë e njëzetë e dy*), ditën e *mërkurë*, para meje Noteres **Rozeta A.Kuka** e regjistruar në Dhomën e Noterëve Tiranë, në Zyren time Noteriale me seli, në adresën, Rr. "Haxhi Dalliu" Hyrja 1, përballë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, u paraqitën personalisht shtetasit si më poshtë vijon për të nënshkruar këtë Kontrate Shit-Blerje Kuotash ("**Kontrata**") ndërmjet:

-Z. Alkid Ademi, atësia Vullnet, amësia Muradije, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Njazi Demi; Nd. 12; H. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1022; Tiranë, lindur më 15/04/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036865849 dhe nr. personal H90415156Q (referuar më tej si: "**Alkid Ademi**").

-Z. Gjergji Mulla, atësia Grigor, amësia Vasilika, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. "Bardhok Biba" Pall.; Nd. 75343; Njësia Administrative Nr. 9; Tiranë 9; 0000; Tiranë, lindur më 02/04/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032662299 dhe nr. personal H90402195J, (më poshtë referuar si "**Gjergji Mulla**")

*nga njëra anë si Shtësat (referuar më tej bashkërisht "**Shitësit**", dhe secili veç e veç si "**Shitësi**")*

dhe

Shoqëria "**ASSECO SEE**" SH.PK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjit të Kosovës, që ka selinë e regjistruar në Prishtinë në Rr. Lidhja e Pejës" nr. 177, 10000 Prishtinë Kosovë, i regjistruar në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve me numrin 810486200, me TIN: 330071845, përfaqësuar nga: nga Administratori **Z. Ardian Shehu**, atësia Nexhmedin, shtetas Kosovar, lindur në Kosovë i datëlindjes 30/05/1973, banues në Tiranë dhe **Arijeta Kabashi**, atësia Zenel, shtetase Kosovare, lindur në Prizren, Kosove dhe banuese në Kosove, lindur më 29/09/1971, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 1014827389 dhe nr. personal 1014827389.

*nga ana tjetër si blerës ("**Blerësi**").*

Në këtë Kontratë Shitje Kuotash, Shitësi dhe Blerësi quhen bashkarisht si "**Palët**" dhe individualisht si "**Pala**").

Palët bien dakord si më poshtë:

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1.1 **Helius Systems SH.P.K.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (në shqip "*Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*"), e themeluar sipas ligjit shqiptar me selinë e saj në Shqipëri, Tiranë Rruga "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort, Kati 11 i kullës horizontale 1001, Tiranë, Shqipëri, Tiranë, 1001, regjistruar

Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.



A2022052810085747683

pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit shqiptare (“QKB”) me NUIS K90607030D (referuar më tej si: “Shoqëria”).

1.2 Shitësit janë mbajtësit dhe pronarët ligjorë dhe përfitues të një totali prej 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë, dhe ata zotërojnë si më poshtë:

- a. Alkid Ademi zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 500.000.00 (pesëqind mijë lekë) që i përkon 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë;
- b. Gjergji Mulla zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 500 000,00 (pesëqind mijë lekë) që i përkon 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

1.3 Në përputhje me detyrimet e tyre që rrjedhin nga Marrëveshja për Shitblerjen e Kuotave të lidhur ndërmjet Palëve me Nr.1858 Rep, Nr.699 Kol datë 27.09.2022 (“SPA”), Palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë në mënyrë që të transferojnë pronësinë e kuotave (siç përcaktohet më poshtë në nenin 3.1) nga Shitësit të Blerësi dhe të regjistrojnë Blerësin si pronarin e vetëm ligjor të kuotave të shitura në të gjitha autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

1.4 Në këtë Kontratë Shitje Kuotash, me përjashtim të rasteve kur konteksti kërkon ndryshe dhe nëse nuk parashikohet ndryshe këtu, fjalët me shkronjë të madhe do të kenë kuptimin e parashikuar në nenin 1 të SPA-së.

2. OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj Kontrate Shitje Kuotash është shitja e kuotave në përputhje me nenin 3 të kësaj Kontrate Shitje Kuotash.

3. SHITJA E KUOTAVE

3.1 Në përputhje me këtë Kontratë Shitje Kuotash, Shitësit pranojnë të shesin dhe transferojnë të Blerësi dhe Blerësi pranon të blejë dhe marrë nga Shitësit një pjesë të kuotave të tyre në Shoqëri, si më poshtë vijon:

3.1.1. Alkid Ademi shet 35% (tridhjetë e pesë për qind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë, të cilat kanë vlerë nominale 350 000,00 (treqind e pesëdhjetë mijë lekë);

3.1.2. Gjergji Mulla shet 35% (tridhjetë e pesë për qind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë, të cilat kanë vlerë nominale 350 000,00 (treqind e pesëdhjetë mijë lekë);

me të gjitha të drejtat që i bashkëngjiten asaj (përfshirë, pa kufizim, të drejtën e votës, të drejtën për të përfituar dividend nga Shoqëria dhe të drejtën për të marrë çdo të ardhur pas likuidimit të Shoqërisë) dhe pa asnjë barrë të çdo lloji, të cilat në total kanë vlerë nominale prej 700.000 (shtatëqind mijë lekë) dhe përfaqësojnë 70% (shtatëdhjetë për qind) të kapitalit të emetuar dhe të regjistruar të Shoqërisë (“Kuotat në shitje”), sipas kushteve të kësaj Kontrate Shitje Kuotash.

3.2 Struktura e ortakëve të Shoqërisë pas ekzekutimit të kësaj Kontrate Shitje Kuotash do të jetë si më poshtë vijon:

Ortak	% e kapitalit	Vlera nominale e kuotës në Lekë
Alkid Ademi	15%	150.000,00
Gjergji Mulla	15%	150.000,00
ASSECO SEE SH.P.K.	70%	700.000,00
Totali	100%	1.000.000,00



4. ÇMIMI I SHITJES

4.1 Blerësi do t'u paguajë Shitësve çmimin për shitjen e kuotave në shumën dhe kushtet e përcaktuara në SPA.

4.2 Të gjitha pagesat që i detyrohen shitësve sipas kësaj Kontrate do të bëhen në llogaritë e mëposhtme bankare të Shitësve:

- Alkid Ademi në llogarinë bankare të mëposhtme:

Bank: Intesa Sanpaolo
IBAN: AL45208113140000096950735102
BICSWIFT: USALALTR

- Gjergji Mulla në llogarinë bankare të mëposhtme:

Bank: Intesa Sanpaolo
IBAN: AL03208112040000062131735101
BICSWIFT: USALALTR

5. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

5.1 Shitësit bien dakord që regjistrimi i kësaj Kontrate në regjistrin tregtar dhe autoritetet e tjera kompetente mund të kryhet menjëherë pa pjesëmarrjen dhe miratimin e tyre të mëtejshëm dhe pa provuar nëse çmimi i përcaktuar në Nenin 4 të Kontratës u është paguar Shitësve. Nëse një pjesëmarrje e tillë e Shitësve kërkohet nga ligjet dhe rregulloret në fuqi, Shitësit janë të detyruar të sigurojnë pjesëmarrjen e tyre personalisht ose përmes përfaqësuesve të tyre përkatësisht të autorizuar dhe do të sigurojnë çdo dokument shtesë për të dhënë një autorizim të tillë në formën e kërkuar ligjore.

5.2 Palët pranojnë dhe bien dakord që SPA do t'i mbijetojë ekzekutimit dhe zbatimit të kësaj Kontrate dhe se përveç rasteve kur kjo Kontratë parashikon shprehimisht ndryshe, kjo Kontratë nuk do të ndryshojë, heqë dorë ose modifikojë në asnjë aspekt kushtet e SPA-së dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate nuk do të cenojë të drejtat ose detyrimet e Palëve sipas SPA-së.

5.3 Secila Palë e kësaj Kontrate përfaqëson dhe i garanton Palës tjetër që kjo Palë ka lexuar dhe kuptuar plotësisht kushtet dhe dispozitat e kësaj Kontrate, që do të thotë se ka pasur mundësinë ta rishikojë këtë Kontratë me këshilltarin e saj ligjor dhe e ka lidhur këtë Kontratë bazuar në gjykimin e saj dhe në këshillën e avokatit të saj ligjor.

5.4 Kjo Kontratë Shitje Kuotash do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e zbatueshme në Shqipëri.

6. BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".



A2022052810085747683


Kjo Kontratë është hartuar me vullnetin e lirë të Palëve nënshkruese në bazë të Legjislacionit Shqiptar, në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, nga të cilat nga një për palët, dhe një për kopje për arkivën e Noterit.

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALA SHITËSE:

Z. Alkid ADEMI

Alkid Ademi 

Data:19.10.2022

Z. Gjergji MULLA

Gjergji Mulla 


Data:19.10.2022

PALA BLERËSE

Për ASSECO SEE SH.P.K.:

Administratori

Z. Ardian Shehu


Ardian Shehu 

Data:19.10.2022



Dhe

Znj. Arijeta Kabashi

Arijeta Kabashi 

Data: 19.10.2022



NOTERE

ROZETA A. KUKA

